

VENDIM
Nr. 129, datë 22.2.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
UNAZA E MADHE E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqe 34 188.8 (tridhjetë e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tetë) m², me vlerë 167 869 732 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë, objekte me vlerë 13 965 786 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 585 000 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit, prej 181 835 518 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, të përballohen nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për vitin 2012.
6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.
7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ZVRPP-së” të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të jepet konfirmim nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për sipërfaqet e regjistruara, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që ata do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Pronarët e objekteve, për të cilat janë bërë shënimet “Leje legalizimi” dhe “Proces kualifikimi nga ALUIZNI”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuidojë pronarët, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 7, 8 dhe 9 të këtij vendimi.
11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pronarët e pasurive të

shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha